

DËSHMOR PAMFILI DHE SHOKËT E TIJ-



E mërkurë, 16 shkurt 2022 – Shenjtori i ditës.

Dëshmor Pamfili dhe shokët e tij. Flavian i Konstandinopojës. Oshënar Maruthai Episkop në Persi.

SOT NUK ËSHTË DITË KRESHME,

KËTË JAVË NUK KRESHMOJMË

- DËSHMOR PAMFILI DHE SHOKËT E TIJ-

Pamfili i shkëlqyer ishte udhëheqësi i korit të dymbëdhjetë martirëve të shenjtë nga vende dhe profesione të ndryshme, të cilët së bashku krijojnë një ikonë të Kishës në të gjithë diversitetin e saj. Pamfili, me origjinë nga Bejruti (Berytus) i Sirisë, ishte nxënësi i Pieriusit, pasuesit të Origjenit në Shkollën Katekitike të Aleksandrisë. Ai ua shpërndau të varfërve pasurinë e tij dhe e la lavdinë e botës për t'iu përkushtuar praktikimit të virtyteve të shenjta dhe meditimit të Fjalës së Perëndisë. Duke qenë një admirues dhe avokat i mësimit të Origjenit, ai la Aleksandrinë dhe shkoi në Qesari të Palestinës, ku u hirotonis prift dhe u bë drejtor i Shkollës Katekitike, të themeluar nga mjeshtri i madh. Jetoj si një martir edhe përpara se të fillonte persekutimi, duke shpërfillur të gjitha kënaqësitë e mishit me anë të asketizmit dhe duke iu përkushtuar me zell të pashuar transkriptimit dhe interpretimit të Shkrimit të Shenjtë, sipas metodës alegorike të mësuesit të tij.

Pamfili u arrestua më 307, kur persekutimi i Maksimin Daiut kishte filluar të godiste me egërsi mbarë Lindjen. E nxorën përpara Urbanit, guvernatorit mizor të Palestinës, i cili, pasi hetoi dijen e tij të madhe në lëmin e filozofisë, i dha urdhër t'u

ofronte sakrificë idhujve. Prifti i shenjtë i Perëndisë i duroi të gjitha torturat me qëndrueshmërinë e një qenieje të patrup dhe pas këtyre e burgosën. Shokët e tij të burgut ishin dhjak Valensi, një njeri fisnik dhe i moshuar, dhe Pavli, që i kishte duruar të rrahurat pa u ankuar.

Ata kaluan në burg dy vjet së bashku, deri kur pesë të krishterë nga Egjipti mbërritën në portat e Qesarisë. Këta u kthyen në atdheun e tyre, pasi kishin shoqëruar disa konfesorë të besimit, të internuar në minierat e Kilikisë. Kur i pyetën në portat e qytetit, këta nuk e fshehën faktin se ishin të krishterë, ndaj i arrestuan si keqbërës dhe i çuan përpara Firmilianit, guvernatorit të qytetit, i cili i torturoi dhe i mori në pyetje. Kur i pyetën për emrat e tyre, në vend që t'u thoshin të vërtetën, këta u përgjigjën se quheshin sipas emrave të profetëve të Dhiatës së Vjetër: Ilia, Jeremia, Isaia, Samueli dhe Danieli. Dhe kur gjykatësi donte të mësonte se nga vinin, këta i thanë me një zë: "Nga Jerusalemi", duke iu referuar qytetit të Jerusalemit të Sipërm, që ndodhet në qiell, Qytetit të Perëndisë së gjallë, atdheut të të gjithë të krishterëve. Kur dëgjoji emrin e vjetër të qytetit rebel, të riquajtur Aelia nga romakët, gjykatësi mendoi se të krishterët ishin mbledhur për të bërë komplot kundër perandorit. Ai urdhëroi ta rrihnin me kamxhik martirin që foli dhe, duke parë se ai mbeti i palëkundur në qëndrimin e tij, e dënoi atë dhe katër shokët e tij me prerje koke.

Por guvernatori nuk u mjaftua me kaq. Ai dha urdhër të sillnin Pamfilin dhe shokët e tij. Ata kishin dhënë provën e qëndrueshmërisë së tyre nën torturë, kur Firmiliani u kishte kërkuar nënshtrimin ndaj idhujve. Edhe këta i dënoi me vdekje si martirët e tjerë.

Ndërsa po i çonin drejt vendit të ekzekutimit, një djalë i ri doli nga turma dhe thirri me zë të lartë, duke kërkuar trupat e martirëve. Porfiri 18-vjeçar, një shërbëtor dhe bir shpirtëror i Pamfilit, u arrestua menjëherë. Magjistrati, më mizor se bishat, ua dorëzoi torturuesve, të cilët i çanë trupin me thonj hekuri derisa i dolën jashtë të përbrendshmet. E copëtuan në mënyrë të frikshme, por ai nuk nxori zë dhe kështu e dënuan të digjej në zjarr të ngadaltë. Ai eci drejt vdekjes pors i një atlet fitimtar. Fytyra i shkëlqente nga hiri hyjnor me sytë drejtuar nga qielli, ndërsa u thoshte miqve të tij udhëzimet e fundit. I lidhur pas një shtylle druri, priti me qetësi flakët, duke mos nxjerrë asnjë britmë dhe fjalë, por vetëm iu lut Jisuit, Birit të Perëndisë, që ta ndihmonte.

Selefki, një ish-ushtar që kishte lënë ushtrinë me qëllim që të ishte më pranë të krishterëve që vuanin, shkoi për t'i thënë Pamfilit se si Porfiri kishte mbaruar martirizimin e tij. Ushtarët e kapën ndërsa po përqafonte të dënuarit e tjerë. E çuan para guvernatorit, i cili e dënoi menjëherë me vdekje. Pak minuta më vonë, Theodhuli, një i moshuar shpresëtar, me pozitë në personelin e Firmilianit, bëri të njohur dashurinë dhe besimin e tij për martirët, duke e puthur Selefkin. Edhe atë e

sollën para Firmilianit, që sa nuk pëlqiste nga zemërimi, urdhëroi ta kryqëzonin, duke e nderuar me një vdekje si të Shpëtimtarit.

Ndërkohë Juliani, një kapadokas i devotshëm i mbushur plot me zellin e Shpirtit të Shenjtë, i cili ishte kthyer në Qesari pas një udhëtimi, shkoi me shpejtësi atje ku ndodheshin trupat e martirëve të shenjtë. Ai i përqafoi dhe i puti me dashuri një e nga një. Edhe atë e arrestuan dhe e çuan te Firmiliani, i cili e dënoi me vdekje të ngadaltë në zjarr. Me një gëzim të madh, jo të kësaj bote, dhe duke e lavdëruar Perëndinë me zë të lartë, ai iu bashkua korit të martirëve.

Pas martirizimit të Pamfilit, udhëheqësit të kësaj kohorte të ndritur, guvernatori i pabesë dha urdhër që trupi i tij bashkë me të shokëve të flakeshin si ushqim për kafshët e egra. Megjithatë, falë Përkujdesjes Hyjnore, asnjë kafshë nuk iu afrua lipsaneve të tyre, të cilat të krishterët i morën dhe i vendosën me nderim në varre.

* * * * *

- FLAVIANI I KONSTANDINOPOJËS -

Pas fjetjes së patriarkut të shenjtë Prokli, në korrik të vitit 446 (20 nëntor), në vend të tij u zgjodh prifti Flavian, ruajtësi i enëve të shenjta dhe i njohur kudo për devotshmërinë dhe virtytin e tij.

Kamerieri i perandorit, Krisafi, që i ishte kundërvënë zgjedhjes së tij, e bindi Theodhosin II (408- 450), t'i kërkonte një dhuratë në ar patriarkut me rastin e zgjedhjes së tij. Për ta turpëruar Krisafin për koprracinë e tij, Flaviani i dërgoi enët e shenjta që i takonin Perëndisë dhe të varfërve. Eunuku u tërbua nga një veprim i tillë dhe që nga ai çast mendonte si të hakmerrej, duke e hequr Flavianin prej fronit. Me këtë mendim në kokë, ai përhapi lajmin e rremë se Pulkeria, motra besimtare e perandorit (17 shkurt), që e kishte praktikisht pushtetin, donte të bënte një betim virgjërie dhe se Flaviani do ta dorëzonte dhjakonëshë. Por, episkopi i shenjtë Flavian i përgënjeshtroi këto fjalë dhe i kërkoi Pulkerisë të shmangte në publik çdo lloj devocioni ndaj tij.

Atëherë Krisafi bëri ç'kishte në dorë për të mbështetur Eftikin, një arkimandrit të njohur i një prej manastireve të qytetit, i cili, duke ndjekur dënimin e Nestorit në Sinodin e Efesit (431), kishte rënë në herezinë e kundërt, atë të Monofizitizmit, duke shpallur se Krishti ka vetëm një natyrë dhe kjo është ajo hyjnore, e cila ka absorbuar tërësisht atë njerëzore gjatë mishërimit. Duke mos pasur kurrfarë kujdesi për të vërtetën dhe i udhëhequr vetëm nga urrejtja dhe ambicia, eunuku mbështeti këtë heretik arrogant, të cilin donte ta vendoste në vend të Flavianit. Herezia e Eftikit u dënua nga Efsevi i Dorileos, në sinodin krahinor të mbajtur më 448 në Konstandinopojë. Ai i kërkoi më shumë se një herë Eftikit që të vinte në sinod, por ky i fundit nuk iu përgjigj thirrjes, për të fituar kohë që të përgatiste mbrojtjen e tij. Më në fund, kur u shfaq, ai pranoi se Krishti kishte vetëm një natyrë dhe ky ishte besimi i tij personal. Eftiki u anatemua menjëherë dhe u përjashtua

nga kungimi, ndërsa Flaviani i shkroi papës së Romës për ta vënë në dijeni për këtë çështje. Papa i shkroi dy letra Flavianit, ku aprovonte veprimet e tij dhe shpallte besimin e vërtetë. E dyta, i famshmi Tomos për Flavianin, u lexua solemnisht në Sinodin e Kalqedonisë dhe kontribuoi shumë në mbrojtjen e Orthodhoksisë.

Eftiki dhe Krisafi nuk e pranuan humbjen në këtë çështje. Pasi siguruan mbështetjen e Dioskurit, patriarkut të paskrupullt të Aleksandrisë, ata lidhën aleancë me perandoreshën Evdhoksia (që kurrë nuk humbiste rast për të luftuar Pulkerinë dhe episkopët orthodhoksë) dhe arritën të bindnin perandorin që të thërriste një Sinod në Efes, për të dënuar Flavianin dhe mbështetësit e tij si neonestorianë. Ky sinod fals, i njohur në histori si “Sinodi Kusar i Efesit”, u mbledh nën drejtimin e Dioskurit, që kishte ardhur nga Egjipti me një numër të madh episkopësh dhe murgjish, të vendosur për të arritur fitoren përfundimtare të Monofizitizmit dhe të rehabilitonin Eftikin. Dioskuri erdhi në sinod jo që të hiqte dorë nga gabimet, por që të akuzonte dhe të hiqte Flavianin nga froni. Për më tepër, në këtë përpjekje ai pati dhe ndihmën e Varsumasit nga Siria, një heretik i njohur, i cili rrinte në gatishmëri të dyert e qytetit për t’i vënë flakën së bashku me një mijë murgj.

Në hapjen e sinodit, legatët e papës u ndaluan me forcë të lexonin një letër të shën Leonit dhe Dioskuri i tha Eftikit të lexonte pohimin e besimit të tij, i cili u shpall si besimi i vërtetë orthodhoks. Ai u rivendos në ofiqin e arkimandritit dhe Flaviani bashkë me Efsevin e Dorileos u gjykuan se duhej të aforizoheshin, sepse kishin mbështetur formulën e dy natyrave në sinodin e mëparshëm të Efesit. Flaviani dhe legatët e papës protestuan më kot dhe Dioskuri nisi të lexonte vendimin për dënimin e tyre. Kur disa episkopë i dolën përpara dhe i kërkuan të mos vazhdonte më tej me dënimin, Dioskuri, duke pretenduar se po e sulmonin, thirri rojat që ta ndihmonin. Dyert u hapën dhe prokonsulli i Azisë u fut brenda, në krye të ushtarëve të armatosur, së bashku me një turmë murgjish e marinarësh. Flaviani ia doli mbanë të shkonte në altar dhe të gjente mbrojtje pranë tij. Ushtarët e morën që atje duke e nxjerrë me dhunë dhe duke e rrahur. Pjesa më e madhe e episkopëve u mbajtën me forcë në bazilikë, duke u thënë se do të dilnin që andej, vetëm nëse do të nënshkruanin deklaratën e besimit heretik, të hartuar nga Dioskuri, dhe largimin e Flavianit nga froni. Flaviani i dërgoi një apel papës, por lajmëtari i çuar prej tij u kap rob. Dioskuri dhe Varsumai, si dhe përkrahës të tjerë, e kapën Flavianin, e rrëzuan përtokë dhe e goditën aq keq, sa ai nuk rezistoi gjatë. Vdiq në Hipida të Lidisë, gjatë rrugës kur po shkonte për në vendin e internimit.

Pas vdekjes së Theodhosit, kur Pulkeria mori regjencën, urdhëroi që trupi i shën Flavianit të sillej solemnisht në Konstandinopojë, për t’u prehur me paraardhësit e tij në Kishën e Apostujve të shenjtë (shkurt 451). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë i

Kalqedonisë, që u mblodh në të njëjtin vit, dënoi herezinë monofizite dhe përjashtoi nga kungimi Dioskurin dhe Eftikin, e numëroi Flavianin midis shenjtorëve dhe e nderoi si martir të besimit.

* * * * *

- OSHNAR MARUTHAI, EPISKOP NË PERSI -

Në kohën e shën Konstandinit të Madh, Liuta, qeveritari i Sofenës, një territor në jugperëndim të Armenisë, ra në dashuri me Mariamën, vajzën e krishterë të qeveritarit të një krahine fqinje, që ndodhej në kufij të Perandorisë Romake dhe asaj Perse. Mariama nuk donte të martohej me një pagan, por, me anë të ndërmjetimit të shën Jakovit të Nisivës (13 janar), prindërit e saj e pranuan këtë martesë. Liuta u pagëzua atë vit për Pashkë, duke iu bindur vizionit të një engjëlli, dhe një pjesë e madhe e popullit të tij përqafoi besimin e krishterë.

Shën Maruthai, i biri i Liutës dhe i Mariamës, u bë një njeri i ditur në çdo degë të dijes, veçanërisht në mjekësi dhe, kur i vdiq i ati, ai e pasoi si qeveritar i Sofenës dhe më vonë u hirotonis edhe episkop i saj.

Me ngjitjen e Jazdegerdit I në fronin e Persisë (399), shën Maruthai u dërgua në oborrin e tij si ambasadori i perandorit roman. Midis shumë mrekullive, ai shëroi mbretin nga një migrenë dhe fitoi përkrahjen e tij. Për rrjedhojë, arriti të siguronte paqe për të krishterët. Jazegerdi donte t'i bënte një dhuratë të madhe në shenjë mirënjohjeje dhe shenjtori i kërkoi trupat e martirëve të shenjtë, që kishin dhënë dëshminë e tyre për Krishtin në Persi gjatë persekutimit të tmerrshëm të Shapurit II (340-379). Lipsanet ishin shumë të vyera dhe shenjtori i dërgoi ato në selinë e vet në Mayerferqat, i cili në atë kohë u bë i njohur si Martiropolis. Disa vite më vonë, ai u kthye në Persi për të marrë pjesë në Sinodin e Seleucisë (410), i cili riorganizoi Kishën e Persisë. Mori pjesë dhe në zgjedhjen e një Katholikosi të ri, dhe nuk reshti kurrë së përkujdesuri për paqen dhe rregullin në Kishën që ndodhej në mbretërinë sasanide.

Magët mazdeanë ishin xhelozë për favorin mbretëror që gëzonte episkopi. Ata fshehën dikë në dhomat e tempullit të zjarrit, kur mbreti po ofronte sakrificën e tij dhe e bënë që ta qortonte gjoja në emër të zotave: "Unë nuk të pranoj ty, sepse ti ke vendosur Maruthain, udhëheqësin e galileasve". I udhëhequr nga hiri i Perëndisë, Maruthai hyri në tempull dhe e bëri të qartë komplotin, duke hapur tavanin ku ishte fshehur njeriu që fliste. Kur mashtruesi rrëfeu se kishte vepruar sipas porosisë së magjistarëve, mbreti i arrestoi. Ai do t'i kishte vrarë ata së bashku me gratë e tyre, por Maruthai i mëshirshëm ndërmjetoi pranë tij që t'ua kursente jetën. Vetëm 12 prej tyre u dënuan. Mbreti i dha leje episkopit të ndërtonte kisha, sa ai të dëshironte, në mbarë territorin e Persisë dhe u dha të krishterëve lirinë e adhurimit, duke i dhënë vendimeve të Sinodit të Seleucisë fuqinë e ligjeve. Sa i takon Maruthait të bekuar, ai fjeti në paqe në qytetin ku ndodhej edhe katedralja

dhe iu bashkua korit të martirëve të shenjtë rreth vitit 420.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)